

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.S. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.5 dhe 1.8, në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit SH.S. av. G.R. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PKR.nr.72/18 të datës 20.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.02.2019 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit SH.S., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë PKR.nr.72/18 të datës 20.09.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktgjykimin PKR.nr.72/18 të datës 20.09.2018 e ka shpallur fajtor të akuzuarin SH.S. ashtu që për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.5 dhe 1.8, në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, dënim në të cilin do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 24.05.2017 gjer me 20.09.2018. Obligohet i akuzuari SH.S. që në emër të procedurës penale të paguaj shumën prej 200 euro dhe shumën prej 50 euro në fondin e viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Kërkesë pasurorë juridike nuk pati. Në bazë të nenit 375 par.3 të KPRK-së, pushka automatike AK-47 me nr. Serik 4224284 me një karikator për këtë pushkë i konfiskohet përhershëm. Urdhërohet Agjencia e Menaxhimit të Pronës së Konfiskuar që të kthej automjetin e tipit “Pezho307” ngjyrë e zezë, më dy dyer, me numër të shasisë 0000000000, me targa franceze të regjistrimit XX-XYZ-XX, gjithashtu dhe çelësat për këtë automjet, pronarit të automjetit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë për shkak te vendimit mbi dënim me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim burgu më të lartë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit SH.S. av. G.R. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe çështjen t’ia kthej Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose që të akuzuarin ta shpall fajtorë për veprën penale Lëndim i rëndë truporë nga neni 166 par.2 të KPRK-së, ose ta ndryshoj aktgjykimin sa i përket vendimit për dënim dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj një dënim burgu për aq sa kohë ka qëndruar ne paraburgim.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezent ishin i akuzuari SH.S. dhe mbrojtësi i tij av. G.R., kurse nuk prezantuan Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari L.T. edhe pse të ftuar me rregull për kohën e mbajtjes së seancës. Avokati mbeti pranë pretendimeve ankimore të parashtruara me shkrim, i akuzuari SH.S. mbështeti fjalët e mbrojtësit dhe nuk ka çka të shtoj me shumë.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.29/19 të dt. 21.01.2019 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me i lartë me burgim, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

#### **-ankesat janë të pa bazuara.**

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.S. av. G.R., në ankesë thekson se aktgjykimi shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.,12 lidhur me nenin 370 par.6 e 7 të KPRK-së sepse gjykata nuk paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron te vërtetuara apo të pa vërtetuara në mënyrë të veçantë nuk e vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse dhe se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërthënie të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur edhe Ligjin Penal në dëm të akuzuarit, kur të njëjtin e shpall fajtorë për veprën penale Vrasje e rëndë ne tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 të lidhur me nenin 28 të KPRK-së sepse i akuzuari nuk është qëllimin që ta privoj nga jeta të dëmtuarin, përndryshe sa i përket kësaj bazë ligjore të ankimit mbetem në tërësi pranë dy ankesave të mëparshme sipas të cilave Gjykata e Apelit i ka aprovuar dhe dy herë aktgjykimet i ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer ne rigjykim.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit SH.S. , si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar ti shqyrtojë. Nga shkresat e lëndës shihet se i akuzuari SH.S. ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar dispozitat ligjore për pranimin e fajësisë duke shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Pretendimet e mbrojtjes nuk janë të bazuara sepse ato bazohen në gabime teknike të kryera gjatë përkthimit por të cilat nuk ndryshojnë bërthamën apo esencën e aktgjykimit përkundrazi shihet qartë se i akuzuari është akuzuar për veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së për çka edhe ka pranuar fajësinë dhe gjykata për këtë veprë penale e ka shpallur fajtorë. Prandaj në rastin konkret nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal pasi që jo vetëm se i akuzuari ka pranuar fajësinë por se ky pranim i fajësisë është i bazuar edhe provat të cilat janë gjendur në shkresat e lëndës e të cilat janë theksuar nga ana e gjykatës se shkalles së parë më rastin e marrjes së aktvendimit për pranimin e fajësisë.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorisë dhe të mbrojtjes nuk janë të bazuara. Në ankesat e tyre nuk theksohen fakte dhe rrethana të reja e të cilat nuk i ka pasur Gjykata e shkallës së parë por prokuroria thekson se gjykata nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe se ka nxjerrë konkluzione të gabuara kur ka aplikuar dispozitën e nenit 75 dhe 76 të KPRK-së ndërsa mbrojtja thekson se vendimi mbi dënim është tejet i ashpër si pasoje e mos vlerësimit të mjaftueshëm të rrethanave lehtësuese dhe vlerësimit të gabuar të rrethanave rënduese. Mirëpo duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të vlerësuara drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë edhe atë si rrethana lehtësuese mori në konsideratë pranimin e fajësisë, se ai ishte i ri në kohën e kryerjes së veprës penale, kishte me pak se 20 vite, pastaj është familjarë se është babai 5 fëmijëve të mitur, pendimi i tij, ishte i sinqerte në kërkim falje të dëmtuarit dhe familjarëve të tij, premtimi se nuk do të kryej me veprën tjetër penale si rrethana rënduese gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, motivin e kryerjes së veprës penale, intensitetin e rrezikimit të dëmtuarit, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale, sjelljen e me parsh me të pandehurit, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.10/2019, më 12.02.2019

Procesmbajtëse,  
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari  
1. Abdullah Ahmeti \_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi \_\_\_\_\_

3. Mejreme Memaj \_\_\_\_\_